

VENDIM NR. 03 datë 20. 07. 2005
I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË TREGTARE
"AURORA GIPS" SHPK



Në Tiranë, sot në datën 20 Korrik 2005, u mbledh Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve të Shoqërisë Tregtare "AURORA GIPS" SHPK, në selinë e saj, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 20. 07. 2005 të përgatitur nga z. Teki FLAMURI, Ekspert Kontabël i Autorizuar;

Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve e përbërë nga z. Rakip Suli dhe z. Seit Suli pasi u njoh me rendin e ditës;

VËREN SE

Shoqëria Tregtare "AURORA GIPS" SHPK, është regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 23287/4 datë 15.01.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ortakë të kësaj shoqërie, janë z. Rakip Suli dhe z. Seit Suli. Kapitali themeltar i nënshkruar i kësaj shoqërie është 100 000 (njëqind mijë) Lekë. Ky kapital është i ndarë në këtë mënyrë:

- c) **Z. Rakip Suli**, zotëron 50 % të kapitalit themeltar të nënshkruar, e barabartë kjo me 50 000 Lekë (Pesedhjetemije);
- d) **Z. Seit Suli**, zotëron 50 % të kapitalit themeltar të nënshkruar, e barabartë kjo me 50 000 Lekë (Pesedhjetemije)

Me Vendimin Nr. 02 datë 29. 06. 2005, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë ka vendosur:

1. Miratimin e llogarive vjetore të shoqërisë tregtare "AURORA GIPS" SHPK, për vitin financiar 2004 (1 Janar –31 Dhjetor 2004);
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë tregtare "AURORA GIPS SH.P.K. me anë të fitimeve të pashpërndara gjatë vitit financiar 2004 dhe fitimeve të mbartura (1 janar –31 Dhjetor 2004);
3. Caktimin e z. TEKI FLAMURI Ekspert Kontabël i Autorizuar, me Nr. Liçence 106 datë 10.01.2001, për vlerësimin e kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31. 12. 2004;
4. Depozitimin e këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë TIRANË.

Ky vendim është depozituar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 22837/1 datë 12. 07. 2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në vështrim të rendit të ditës, Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve të kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 12. 07. 2005, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Autorizuar z. TEKI FLAMURI, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar. Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet nga 100 000 (njëqind mijë) Lekë në **13 165 645** (Trembedhjetmilioneenjqintegjashtedhjetepesemijegjashteqintedyzetepese).

Ky kapital do të zotërohet nga ortakët në këtë mënyrë:

- a) **Z. Rakip Suli**, do të zotërojë 50 (Pesedhjete) pjesë te kapitali e barabartë kjo me vlerën e 6 582 822.5 (Gjashtemilione pesqintetehjetedymijetetqintenjezetedypikpese) Lekësh duke qenë kështu 50 % zotërues i kuotave të kapitalit
- b) **Z. Seit Suli**, do të zotërojë 50 (Pesedhjete) pjesë te kapitali e barabartë kjo me vlerën e 6 582 822.5 (Gjashtemilione pesqintetehjetedymijetetqintenjezetedypikpese) Lekësh duke qenë kështu 50 % zotërues i kuotave të kapitalit .

Për këto arsye, Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve, me votim unanim;

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë , të datës 20. 07. 2005, përgatitur nga z. Teki Flamuri, Ekspert Kontabël i Autorizuar;
Zmadhimi i Kapitalit Themeltar të nënshkruar të kësaj shoqërie nga 100 000 (njëqind mijë) Lekë në **13 165 645** (Trembedhjetmilioneenjqintegjashtedhjetepesemijegjashteqintedyzetepese).
2. Zotërimi i kapitalit nga ortakët të jetë në këtë mënyrë:
 - a) **Z. Rakip Suli**, do të zotërojë 50 (Pesedhjete) pjesë te kapitali e barabartë kjo me vlerën e 6 582 822.5 (Gjashtemilione pesqintetehjetedymijetetqintenjezetedypikpese) Lekësh duke qenë kështu 50 % zotërues i kuotave të kapitalit
 - b) **Z. Seit Suli**, do të zotërojë 50 (Pesedhjete) pjesë te kapitali e barabartë kjo me vlerën e 6 582 822.5 (Gjashtemilione pesqintetehjetedymijetetqintenjezetedypikpese) Lekësh duke qenë kështu 50 % zotërues i kuotave të kapitalit .
3. Depozitimi i këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë TIRANË

ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME E SHOQËRISË TREGTARE "Aurora Gips" SHPK

ORTAKET

(Rakip Suli)

(Seit Suli)

